

**STATUT dhe AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"Mema Development" sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me date 26.10.2020 u mbledh:

Besmir Mema, i datelindjes 08.06.1985, shtetas Shqiptare, madhore dhe me zotesi të plote per të vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr personal I50608002S.

I cili, me cilesine e " Ortakut ", redaktoi ketu statutin, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, ne Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, te krijoje shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "Mema Development" sh.p.k.

**KREU I**

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emertimi**

Emërtimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është "Mema Development" sh.p.k.

**Neni 2**

**Forma Juridike**

Shoqeria "Mema Development" sh.p.k. eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personat fizikë dhe juridike te siperpermendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.



### Neni 3

#### Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet Tirane, Tirane Njesia Bashkiake/administrative NR.1.,  
Rruga Fatmir Agalliu, banese private, kati i pare.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale,  
si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se  
Ortakeve.

### Neni 4

#### Objekti i veprimtarise

- a) Zhvillim aplikacione ne web dhe mobile dhe sherbime ndihmese ne fushen e informatikes.
- b) Fushata marketing dhe krijim/ dizenjim/hostim faqesh internet
- c) Konsulence per hartime programesh per fusha te ndryshme te sistemeve informatike,studime, keshillime per probleme te informatikes drejtimin ekonomiko-financiare, importim dhe eksportim sistemesh per perpunimin e te dhenave, etj.
- d) Sherbime ne fushen e sistemeve te teknologjise se informacionit dhe komunikacionit, trajnime dhe kurse kualifikimi, shitblerje, zhvillim software, sherbime transmetimi dhe gjenerim dhe perpunim te dhenash., programin, marketing dhe administrim websitesh .
- e) Sherbime ndihmese ne fushen e informatikes. menaxhim i rrjeteve sociale, web desing, marketing i permbajtjes, sherbime kerkimi, konsulence, materiale promocionale, Web Desing. Web Hosting. Rregjistrim domainsesh. Punime grafike. Internet marketing. Email marketing. Perkthime te gjuheve te huaja Online. Seo. Sherbime online.

### Neni 5

#### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

### KREU II

#### KAPITALI

### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i shoqerise perkatesisht:



Besmir Mema, i datelindjes 08.06.1985, shtetas Shqiptare, madhore dhe me zotesi të plote për të vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit me nr personal I50608002S. Zoterues i kuotave, që përfaqesojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 100 000 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të treteve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices së cilesuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMARRRESE DHE DREJTUESE

### Neni 8

#### Organi Vendimarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 9

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave të zoteruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### Neni 10

#### Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

**Administrator i shoqërisë është Besmir Mema, i datelindjes 08.06.1985, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit me nr personal I50608002S, e cila do të ushtroje funksionet në këto detyra për një periudhë 5 vjetore me të drejtë ripërtëritje.**



Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### Neni 11

#### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) Administratori në respekt të dispozitave ligjore, mund të kryejë të gjitha operacionet që do të jnë të konsideruara nga administratori të nevojshme dhe të dobishme për të arritur objektivat sociale aty përfshirë leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave të tretë.
- f) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur : Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.



Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### **Neni 12**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 13**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper ".

#### **Neni 14**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### **Neni 15**

##### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.



**Neni 16**

**Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "Mema Development" sh.p.k.

**O R T A K E T**

**B E S M I R M E M A**

